

## STATUT

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “GO ELECTRIC ALBANIA ” SH.P.K.

KREU I  
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

#### Neni 1 Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot më datë 13.9.2023. themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “**GO ELECTRIC ALBANIA ”SH.P.K.**, në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”. Themeluesit e Shoqërisë janë:

- 1) **ALBANO DUSHA**, atësia Leonard i lindur në Tiranë më 10.02.1987 dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar i pajisur me dok identifikimi Id me Nr **035829914** dhe Nr personal **I70210067I**
- 2) **JORGJI DUSHA** atësia Emiljano i lindur në Tiranë më 23.05.1999 dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar i pajisur me dok identifikimi pasaporte me Nr **BE0842203** dhe Nr personal **J90523029E**

#### Neni 2 Objekti

Shoqëria “**GO ELECTRIC ALBANIA ”sh.p.k.** do të ushtrojë aktivitetin e saj në fushën e import – export të artikujve të ndryshëm industrial. Dhënie me qira automjetesh. Shitblerje automjetesh të reja dhe të përdorura. Oficinë. Servis automjetesh. Tregti pjese këmbimi të reja dhe të përdorura. Marrja e përfaqësise në aktivitetin tregtar të automjeteve. Marrja e perfaqësise, tregtimi, dhënia me qira e mjeteve, detare lundruese të çdo lloji.

#### Neni 3 Kohëzgjatja

Shoqëria “**GO ELECTRIC ALBANIA ”sh.p.k.**, do ta zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

#### Neni 4 Selia

Selia e shoqërisë “**GO ELECTRIC ALBANIA ”sh.p.k.**, do të jetë në adresën: ZONA KADASTRALE NR 8160 NR PASUIRE 6/121-N21, RRUGA “DERVISH HIMA” 3 KULLAT, KULLA NR 3 KATI 1 TIRANE

## KREU II

### Kapitali

#### Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisështë 100.000(njeqind mijë) Lekë. Pjesëmarra e themeluesve në kapitalin e shoqërisështë në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- 1) Ortaku themelues **JORGJI DUSHA** Zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 51,000 (pesëdhjet një mijë) lekë që përbën 51% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Ortaku themelues **ALBANO DUSHA** Zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 49,000 (dyzet e nëntë mijë ) lekë që përbën 49 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### Neni 6

### Zmadhimi dhe Zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.  
Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### Neni 7

### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- ç) Dhurimit;
- d) Çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj;

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Ortakët kanë të drejtën e parablerjes së kuotave.

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

### **KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE**

#### **Neni 8 Organi Vendimmarrës**

Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i vetëm i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

1. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
2. Ndryshimin e statutit;
3. Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
4. Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të miratuar;
5. Përcaktimin e shpërblimeve për administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabël;
6. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
7. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
8. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
9. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
10. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
11. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
12. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të shoqërisë;
13. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

#### **Neni 9 Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vandin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 10 Kuotimi**



Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, në të njëtin rend dite.

### **Neni 11 Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### **Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendimin për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja;

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13 Administrimi**

(1) Administratori i shoqërisë emërohet JORGJI DUSHA, atësia Emiljano, shtetas Shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër personal identifikimi J90523029E, i datëlindjes



**23.05.1999**, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

(2) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(3) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(4) Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

#### **Neni 14 Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqerinë tregtare;
- c) kujdesen përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente para asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e vepprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivitet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerën më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqerinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë te marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, irregullohen sipas dispozitave në fuqi.

#### **Neni 15 Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14,15,17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a)të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;

b)të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

c)të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d)të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

a)u kthen ortakëve kontributet;

b)u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c)u shpérndan aktivet e shoqërisë;

c)lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d)jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

**Kreu IV**  
**Viti finansiar – ekspertët**

**Neni 16**  
**Viti Financiar**

Viti finansiar i Shoqërisë fillon më 01 Janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylltet me 31 dhjetor.

**Neni 17**  
**Eksperët**

Eksperi ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperi kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t’ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t’i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

**Kreu V**  
**Prishja – riorganizimi i shoqërisë**


**Neni 18**  
**Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 ‘Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit’;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likujdatorë dhe shënuar nëcdodokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë ‘Shoqëri në likuidim e sipër’.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave tëlikujdimit në gjendjen e aftësisëpaguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.



Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët.

Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të ligjit 9901 datë 14.04.2012 ‘Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare’.

**Neni 20**  
**Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohendizpozitat e ligjit ‘Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare’, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo marrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe tjetërve, do jetë kompetente Gjykata shqiptare.

**ORTAKËT E  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“ GO ELECTRIC ALBANIA ”sh.p.k**

ALBANO DUSHA

JORGJI DUSHA

*ACBANO DUSHA*

*JORGJI DUSHA*

